



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Tiranë

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 368 Prot

Tiranë më 05.05.2016

V E N D I M

Nr. 48, datë 05/05/2016

“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Cërrik”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbikëqyr kryesisht, ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Për këtë arsye,

me propozim të Drejtorisë së Përgjithëshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionet që përfshihen në këtë fushë,

VENDOSA:

1. Fillimin e mbikëqyrjes tematike në institucionin e Bashkisë Cërrik, sipas objektit dhe anekseve që përmban Programi i Mbikëqyrjes, i cili është pjesë e këtij vendimi.
2. Ngritjen e grupit të mbikëqyrjes, me këtë përbërje:

- **Altin Shumeli** **Drejtori i Mbikëqyrjes**
(Drejtues teknik)
- **Dorina Nika** **Specialiste**
(Përgjegjës grupi)
- **Ledina Zhupa** **Inspektor**
(Anëtar)

3. Mbikëqyrja do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt në datën **10.05.2016** dhe do të vijojë procesi i grumbullimit të dhënave, deri në datën **17.05.2016**. Nëse, gjatë fazës së përpunimit të të dhënave, lind nevoja për të përsëritur vizitën në subjekt, ky proces do të realizohet me kërkesën e grupit të punës.

4. Me përfundimin e këqyrjes së akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i mbikëqyrjes, nën drejtimin teknik të Drejtorit të Mbikëqyrjes, do të vijojë procesin me përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e projekt raportit të mbikëqyrjes. Projektraporti do të përfundojë në datën **31.05.2016** dhe pasi t'i paraqitet Komisionerit për miratim, më tej, do t'i dërgohet institucionit të mbikëqyrur për t'u njohur me gjetjet, duke i lënë 5 ditë kohë për të përgatitur observacionet.
5. Pas përfundimit të afatit për njohjen e subjektit të mbikëqyrur me raportin paraprak, grupi i punës do të hartojë raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ku do të përfshihet edhe analiza e observacioneve, e në datën **15.06.2016**, do t'i paraqitet Komisionerit për miratim.
6. Nëse gjatë procesit të mbikëqyrjes nuk arrihet të respektohen afatet e vendosura, drejtuesi i grupit të punës duhet të kërkojë zgjatje afati tek Komisioneri, duke argumentuar edhe arsyet për mos përfundimin e procesit në afat.
7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithëshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 47 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
8. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që të sigurojë mbështetjen e grupeve të mbikëqyrjes me logjistikë, për vijimin normal të procesit, në përputhje me programin e miratuar.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Tiranë

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 368/1 Prot.

Tiranë, më 05.05.2016

M I R A T O H E T

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONER

PROGRAM MBIKËQYRJEJE

(Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil)

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** **Bashkia Cërrik**
- 2. Objekti i mbikëqyrjes:** Mbikëqyrje tematike për zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me respektimin e kërkesave ligjore gjatë procesit të deklarimit të statusit të punësimit, për çdo punonjës të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.
- 3. Baza ligjore:** Nenet 11, pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, që përcaktojnë kompetencat e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;
- Neni 67 i ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, që përcakton kategoritë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, kushtet ligjore, si dhe procedurat specifike që duhet të ndiqen për realizimin e procesit;
- Vendimi nr. 116/2014 "*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" të Këshillit të Ministrave*", i ndryshuar.

4. Periudha e mbikëqyrjes:

Mbikëqyrja do të përfshijë sipas objektit, veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e në vijim.

Për verifikimin e zbatimit të ligjit nr. 8549/1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”, në lidhje me mënyrën e rekrutimit, mbikëqyrja do të shtrihet edhe në akte të dala para datës 26 shkurt 2014.

5. Afati i mbikëqyrjes:

Mbikëqyrja do të fillojë në institucion në datën 10.05.2016 dhe do të përfundojë brenda datës 17.05.2016.

6. Procedura që do të ndiqet:

Për parregullsitë e konstatuara do të mbahet proces-verbal administrativ dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.

7. Grupi i punës:

- | | |
|-------------------------|--|
| 1. Altin Shumeli | Drejtori i Mbikëqyrjes
(Drejtues teknik) |
| 2. Dorina Nika | Specialiste
(Përgjegjës grupi) |
| 3. Ledina Zhupa | Inspektor
(Anëtar) |

8. Dokumentimi i rezultateve të mbikëqyrjes:

Në përfundim të procesit të këqyrjes dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, do të përgatitet projekt-raporti i mbikëqyrjes, me të cilin do të njihen personat përgjegjës për t`i dhënë mundësinë e sqarimeve dhe të paraqitjes së observacioneve. Më pas do të hartohet raporti përfundimtar i mbikëqyrjes, i cili do t`i dërgohet institucionit, i shoqëruar me rekomandimet dhe paralajmërimet përkatëse për të rregulluar ligjshmërinë.

DREJTIMET E MBIKËQYRJES

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.

2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr.8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit;
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese, ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
 - Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil;
 - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e verifikimit dhe deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve (kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.).
3. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

9. Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes.

Në vijim të programit të mbikëqyrjes, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për të përfunduar këtë proces.

1. Struktura organizative dhe analitike aktuale e institucionit.
2. Struktura organizative dhe analitike e institucionit që ka qënë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit për nëpunësin civil, ku përfshihen edhe strukturat e bashkive dhe komunave që janë bërë pjesë e subjektit të mbikëqyrur, pas riorganizimit territorial (data 26.02.2014).
3. Struktura organizative dhe analitike e institucionit që ka qënë në fuqi para momentit të fillimit të efekteve të ligjit për nëpunësin civil (para datës 26.02.2014, nëse ndryshon nga ajo e parashikuar në pikën 2 të këtij aneksi).
4. Listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve të institucionit për muajin shkurt 2014.
5. Listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve të institucionit për muajin prill 2016.
6. Aktet që materializojnë procesin konkurrues të hyrjes në shërbimin civil, në përputhje me ligjin nr. 8549/1999 “*Statusi i nëpunësit civil*” (i shfuqizuar), ndër të cilat:
 - Shpallja e konkurimit;
 - Akti i krijimit të komitetit *ad-hoc*;
 - Aktet që materializojnë testimin me shkrim;

- Aktet e emërimit pas konkurimit;
- Aktet që materializojnë lëvizjen paralele (shpallja e pozicionit, përzgjedhja dhe akti i emërimit);
- Aktet që materializojnë procedurën e ngritjes në detyrë (shpalljen e pozicionit të lirë, testimi, përzgjedhja dhe emërimi).

7. Akti i deklarimit të statusit të nëpunësit civil.

8. Dosjet e personelit dhe regjistri i personelit.

9. Materiale të tjera, të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të mbikëqyrjes.

**DREJTORIA E PËRGJITHËSHME
E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Arbana BASHA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM